

VENDIM
Nr. 33/2022

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS SË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:


- I. Struktura e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.
- II. Organika e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 29.
- IV. Vendimi nr. 34/2016, datë 28.4.2016, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)” shfuqizohet.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.4.2022.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERRU

Lidhja nr.1



ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Lidhja nr. 2

| KOMISIONI I ERRU-së | Kategoria e pagës | Numri |
|---|--------------------------|--------------|
| KRYETARI | | 1 |
| ANËTARË KOMISIONI | | 4 |
| Sekretarja e Komisionit dhe kryetarit | | 1 |
| SEKRETAR I PËRGJITHSHËM | I-b | <u>1</u> |
| | | |
| DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE | | <u>9</u> |
| Drejtor drejtorie | II-b | 1 |
| | | |
| <i>Sektori Teknik dhe i Licencave</i> | | |
| Përgjegjës sektori | III-a | 1 |
| Specialist i Rrjeteve Inxhinierike të Ujës-jellësve dhe ITUP | III-b | 1 |
| Specialist i Rrjeteve Inxhinierike të KUN dhe ITUN | III-b | 1 |
| | | |
| <i>Sektori Ekonomik dhe Tarifave</i> | | |
| Përgjegjës sektori | III-a | 1 |
| Specialist i Analizës Ekonomiko-financiare | III-b | 1 |
| Specialist i Analizës së Aseteve dhe Investimeve | III-b | 1 |
| | | |
| <i>Sektori i Monitorimit dhe Performancës</i> | | |
| Specialist i Performancës Operative dhe Cilësisë së Shërbimit | III-b | 1 |
| Specialist i Performancës Ekonomiko-financiare | III-b | 1 |
| DREJTORIA JURIDIKE DHE E KONSUMATORIT | | <u>5</u> |
| | | |
| Drejtor drejtorie | II-b | 1 |
| | | |
| <i>Sektori Juridik</i> | | |
| Specialist ligjor | III-b | 2 |
| | | |
| <i>Sektori i Marrëdhënive me Publikun dhe Konsumatorin</i> | | |
| | | |
| Specialist i Trajtimit të Ankesave | III-b | 1 |
| Specialist i Marrëdhënive me Publikun | III-b | 1 |
| DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE | | <u>8</u> |
| | | |
| Drejtor drejtorie | II-b | 1 |
| <i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i> | | |
| | | |
| Specialist i Burimeve Njerëzore | III-b | 1 |
| Specialist Finance | III-b | 1 |
| | | |
| <i>Sektori i Shërbimeve</i> | | |
| | | |
| Specialist IT | III-b | 1 |
| Specialist Protokoll-arkiv | IV-b | 1 |
| | | |
| <i>Punonjës mbështetës</i> | | |
| Shoferë | | 2 |
| Magaziniere dhe sanitare | | 1 |
| | | |
| TOTALI | | 29 |